



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2003 / Prot. 6

Vlorë më, 19.12. 2022

VENDIM
Nr. 48 datë 19.12.2022

PËR
PAGESËN E MBINGARKESËS MËSIMORE PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.29, datë 10.09.20218 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", Vendimit të SA nr.29, datë 27.07.2022 "Për pagesën e mbingarkesës mësimore të realizuar për stafin akademik per vitin akademik 2021-2022", si dhe referuar propozimit të Zv/Rektorit Akademik ardhur me shkresën nr.1929 prot, datë 09.12.2022 si dhe shkresës së Administratorit nr.1985/1, datë 16.12.2022, Bordi Administrimit në mbledhjen e datës 19.12.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e mbingarkesës mësimore për orët mbi 300 orë në auditor për vitin akademik 2021-2022, vetëm për rastet ku ekziston propozimi i Njesisë Bazë dhe miratimi i drejtuesit të Njesisë Kryesore, i cili e konsideron si rast specifik.
2. Të miratojë pagesën për orët suplementare të realizuara për udhëheqje diplome, për vitin 2021-2022 sipas shkresës nr.1985/1, datë 16.12.2022.
3. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi do të mbulohen nga Buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. ✓ ✓

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Sotir NIKOLLA

